

## **Die Schulpsychologischen Dienste** Shërbimet e psikologjisë shkollore

Shërbimet e psikologjisë shkollore janë një ofertë e shkollës popullore. Ato janë shërbime falas në dispozicion të prindërve, fëmijëve, të rinjve, mësuesve, drejtorive shkollore dhe anëtarëve të organeve kompetente.

Shërbimet e psikologjisë shkollore këshillojnë dhe shoqërojnë në rastin e vështirësive të edukimit, problemeve emocionale dhe shkollore. Kjo përfshin për shembull çështje në lidhje me aftësinë e të mësuarit dhe të arritjes së rezultateve, aftësinë shkollore, nivelin e dhuntive, mobbing, vështirësitë e zhvillimit, vështirësitë psikike, temat e adoleshencës etj.

Si bazë për këshillimin shërben më së shumti një i ashtuquajtur sqarim diagnostik (Diagnozë = shikim përshkues). Sipas problemit që shtrohet edhe një sqarim i tillë është i ndryshëm. Shpesh bëhet matja e aftësisë intelektuale për arritjen e rezultateve. Shpeshherë merren parasysh në analizë edhe faktorët socialë si edhe gjendja psikike/emocionale.

Qëllimi i punës psikologjike shkollore është të përkrahë prindërit dhe shkollën në detyrën e tyre të edukimit dhe të arsimit dhe kështu të nxisë shanset e të mësuarit dhe të jetës tek fëmijët. Psikologjia shkollore punon në aktivitetin këshillues më së shumti sipas parimeve sistematike dhe të orientuara nga zgjidhjet. Shërbimet e psikologjisë shkollore mund të bëjnë kërkesa zyrtare edhe për masat e shkollave të veçanta ose masat e tjera.

Psikologët dhe psikologët e shkollës kanë mbaruar një shkollë të lartë ose shkollë të lartë profesionale në psikologji dhe më së shumti kanë kryer një studim pasdiplomar për psikologjinë e fëmijëve dhe të rinjve dhe/ose për psikoterapi.

Prill 2010